



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 03.12.2024

Nr: 41

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 29, DATË 20.11.2024
TË DEPOZITUAR NGA PARTIA MINORITETI ETNIK GREK PËR TË ARDHMEN**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 03.12.2024, me pjesëmarrjen e:

Illirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 186, datë 09.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

1. Subjekti Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen depozitoi pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, u regjistrua në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 29 regj., datë 20.11.2024. Në këtë kërkesë ankimore ankuesi kundërshton vendimin nr. 186, datë 08.11.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Ilirjan Rusmali si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës paraprake në datën 03.12.2024, ora 11:30. Në seancë ishin të pranishëm anëtarët e KAS-it dhe administrata e KQZ-së.
3. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 29, datë 20.11.2024;
 - Kërkesën nr. 03, datë 15.11.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Vendimin nr. 186, datë 09.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

KAS-i konstaton:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 186, datë 09.10.2024, si hap procedural përmbyllës për hetimin administrativ. Mbi këtë bazë KSHZ ka proceduar me kërkesën e tij nr. 03, datë 15.11.2024 për vendosje sanksioni administrativ për disa subjekte, ku bën pjesë edhe Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen.
2. Vendimi nr. 186, datë 09.10.2024 shpreh vetëm vullnetin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vënë në lëvizje KAS-in me kërkesën për marrjen e masës administrative me gjobë. Ky vendim nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe nuk cënon asnjë interes të palëve të prekura, sepse kompetenca për vendosje sanksioni administrativ është kompetencë e KAS-it.
3. Të drejtat e palëve të prekura, në rastet e procedimit me kërkesë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbrohen vetëm duke marrë pjesë si palë në shqyrtimin administrativ që zhvillohet nga KAS-i, dhe jo me procedurë ankimore ndaj vendimit përmbyllës të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i ,

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 29, datë 20.11.2024, të depozituar nga Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 03.12.2024.

Iirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar